

VENDIM
Nr. 92, datë 28.7.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 12, DATË 16.2.2018, “PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-
KANALIZIME TEPELENË, PËR NDRYSHIM DREJTUESI TEKNIK”**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale, për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullorja e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 28.7.2020, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tepelenë sh.a. (UK Tepelenë) për ndryshim të licencës për shkak të ndryshimit të drejtuesit teknik”,

VËREN SE:

1. Shoqëria UK Tepelenë, me shkresën nr. 245 prot., datë 9.7.2020, me lëndë “Kërkesë për ndryshim licence”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe në Rregulloren e Licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Tepelenë për rinovim licence, për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në Rregulloren e Licencimit.

3. ERRU-ja ka licencuar shoqërinë UK Tepelenë me vendimin nr. 15, datë 28.4.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Tepelenë”, (vendimi i KKRR-së nr. 15, i ndryshuar) me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Tepelenë sh.a. plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi profilin e edukimit.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Tepelenë sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe të Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Tepelenë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 12, datë 16.2.2018, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Tepelenë për ndryshim drejtuesi teknik” bëhet ndryshimi si më poshtë:

“Drejtues Teknik Myftar Beqo”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani